

Doracak për trajnerët

M3-A1 - Hyrje dhe pyetje, se çka presin pjesëmarrësit nga seminari

Synimet

- Pjesëmarrësit (PM) kanë një pasqyrë mbi temat
- PM kanë njohuri mbi organizimin e seminarit
- PM kanë identifikuar domethënien e temave për vete, karrierën e tyre profesionale dhe për mirëqenien e tyre personale
- PM kanë shprehur pritjet e tyre nga seminari

Qëllimet

- PM e ndiejnë veten në vendin dhe seminarin e duhur dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë
- Pyetjet, në lidhje me atë se çka presin pjesëmarrësit nga seminari i mundësojnë trajnuesit, që të vepron i orientuar në pjesëmarrësit.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
0900	Përshëndetja, Prezentimi	Përshëndetja, prezentimi i trajnuesit	Ligjërime	slajdi # 1
0905	Synimet	Synimet <ul style="list-style-type: none"> ● Pjesëmarrësit kanë një pasqyrë mbi temat ● PM kanë njohuri për organizimin e seminarit ● PM kanë identifikuar domethënien e temave për vete, karrierën e tyre profesionale dhe për mirëqenien e tyre personale ● PM kanë shprehur pritjet e tyre personale nga seminari 	Ligjërime, Diskutim	slajdi # 2
0910	Metodat	Metodat <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligjërime 2. Punë individuale 3. Punë në grupe 4. Punë e moderuar në grupe 	Ligjërime, Diskutim	slajdi # 3
0915	Pasqyrë mbi kapitujt	Kapitujt <ol style="list-style-type: none"> 1. Hyrje dhe pyetje drejtuar pjesëmarrësve për pritjet e tyre nga ky seminar 2. Bashkëpunimi me këshillin e shkollës 3. Bashkëpunimi me prindër 4. Bashkëpunimi me nxënës 5. Rregullat e sjelljes në shkollë 6. Detyrë praktike 7. Përfundim 8. Thellim 9. Testim <p style="color: red;">Periudha ndërmjet dy seancave</p>	Ligjërime, Diskutim	slajdi # 4 slajdi # 5

M3-A1 - Hyrje dhe pyetje, se çka presin pjesëmarrësit nga seminari

0930	Organizimi	Detajet organizative (të përcaktohen në seminarë) <input type="checkbox"/> Koha <input type="checkbox"/> Ushqimi <input type="checkbox"/> Shfrytëzimi i materialit mësimor <input type="checkbox"/> Rregullat e lojës për punën <input type="checkbox"/> etj.	Ligjërime	Tabela Flip
0940	Pyetje për pritjet e pjesëmarrësve nga seminari	Pyetje për pritjet e pjesëmarrësve nga seminari	Anketim me anë të kartelave	Tabelë afishimi. kartelat/letrat gjilpërat me kokë
1015	Pauzë			

M3-A2 - Bashkëpunimi me këshillin e shkollës

Synimi

PM mund të formojnë një këshill shkollor për shkollën e tyre dhe të bashkëpunojnë me të në mënyrë konstruktive

Qëllimi

PM përfitojnë nga obligimet dhe të drejtat e këshillit të shkollës

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metoda	Ilustrimet
1030	Hyrje	Synimi, qëllimi	Ligjërime	sllajdi # 1 sllajdi # 2
1040	Të drejtat e këshillit të shkollës	<p>Këshilli i shkollës ka të drejtën</p> <ul style="list-style-type: none"> ● për përpilimin e rregullave shkollore dhe parashtrimin e tyre tek kuvendi komunal për miratim ● për të vendosur lidhur me shfrytëzimin e mjeteve financiare, të cilat i janë vënë në dispozicion shkollës nga ana e prindërve dhe burimeve të tjera jashtë sektorit publik ● për të vendosur në lidhje me aktivitetet jashtë-kurrikulare <p>Këshilli i shkollës duhet të ketë parasysh</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me <ul style="list-style-type: none"> ● ndërtesën e shkollës ● hapësirën e shkollës dhe ● mjetet mësimore 2. në çështjet e kurrikulës specifike për shkollën 3. në të gjitha direktivat dhe qëndrimet e kuvendit komunal për çështjet e arsimit në Kosovë 4. në terminet e festave lokale 	Ligjërime, Diskutim	sllajdi # 3 sllajdi # 4 Kopjet për PM
1100	Obligimet e këshillit të shkollës	<p>Anëtarët e këshillit të shkollës përmbushin përgjegjësinë e tyre të përgjithshme për shkollën,</p> <ul style="list-style-type: none"> ● duke u interesuar për punën e shkollës ● duke i përkrahur synimet dhe qëllimet e shkollës ● duke siguruar trajtimin të barabartë për të gjithë, të cilët kanë të bëjnë me shkollën (gjinia, etj.) ● duke përkrahur interesat e nxënësve-jo vetëm ato personale 	Ligjërime	Tabelë Flip, tabelë afishimi. dërrasa e zezë, kopjet për PM

		<ul style="list-style-type: none"> ● duke siguruar, se janë të njoftuar me pikëpamjet e grupeve, që ata përfaqësojnë dhe duke informuar ata (përmes bisedave, mbledhjeve, letrave informative dhe raporteve vjetore) ● duke evituar konfliktet e interesit ● duke ruajtur mirëbesimin e informatave personale 		
1120	Përbërja e këshillit të shkollës	Këshilli i shkollës përbëhet prej <ul style="list-style-type: none"> ● 3 prindërve ● 5 mësimdhënësve ● 1 nxënësve (vetëm shkollat e mesme) ● drejtorit të shkollës (pa të drejtë vote) 	Ligjërime	sllajdi # 5 Kopjet për PM
1130	Periudha e qeverisjes së këshillit shkollor Rizgjedhja Zgjedhja e kryetarit Obligimet e kryetarit	Periudha e qeverisjes së këshillit shkollor zgjat tre vite, sa kohë që ata janë pjesëtarë të shkollës ose fëmijët e tyre janë në shkollë. Rizgjedhja: Prindërit dhe mësimdhënësit mund të zgjedhen edhe për herë të dytë. Kryetari zgjedhet sërish secilin vit. Të drejtë vote kanë të gjithë anëtarët e këshillit të shkollës. Vetëm prindërit mund të kandidohen. Kryetari është përgjegjës për realizimin e mbledhjeve. Ai duhet të kujdeset për atë, që të gjithë të kenë rastin për pjesëmarrjen në diskutime.	Ligjërime	sllajdi # 6 Kopjet për PM
1200	Pushimi i mesditës			
1300	Zgjedhja e këshillit të shkollës	Zgjedhja e këshillit të shkollës bëhet në mënyrë të fshehtë. Mënyra e zgjedhjes paracaktohet nga ana e kuvendit komunal, me ç’rast duhet të kihet parasysh paracaktimet e ministrisë Parimi: Mësimdhënësit i zgjedhin mësimdhënësit Nxënësit i zgjedhin nxënësit Prindërit i zgjedhin prindërit	Ligjërime	sllajdi # 7 Kopjet për PM
1310	Roli i drejtorit	Drejtori është sekretar i këshillit të shkollës dhe është përgjegjës për organizim: <ul style="list-style-type: none"> ● Përpilimi i rendit të ditës në marrëveshje me kryetarin ● Thirrja e mbledhjeve ● hartimi i protokollëve të mbledhjeve ● realizimi i korrespondimit ● Arkivimi i protokolleve dhe raporteve 	Ligjërime	sllajdi # 8 sllajdi # 9 Kopjet për PM

		të këshillit të shkollës Drejtori raporton këshillin e shkollës mbi aktivitet e shkollës dhe financat. Ai ka të drejtë të jep modelet e vendimeve dhe t'i përfaqëson ata nëpër debate, mirëpo nuk guxon të voton.		
1320	Rregullat plotësuese	Në qoftëse këshilli i shkollës nuk mund të themelohet ose nuk mund të mbledhet për një periudhë kohore më të gjatë se tre muaj, atëherë drejtori i shkollës duhet t'i merr përsipër detyrat e këshillit të shkollës. Mirëpo drejtori i shkollës duhet të bëjë ç' të jetë e mundur për të themeluar këshillin e shkollës. Ai duhet të kujdeset për atë, që këshilli i shkollës të mund t'i zhvillon punimet së paku një herë në vit. Këshilli i shkollës mund të fton në mbledhje drejtorin e arsimit pranë kuvendit komunal dhe zyrtarin për arsim.	Ligjërime	slajdi # 10 Kopjet për PM
1330	Hartimi i një plani të aktiviteteve	Po të ishit drejtor, si kishit për ta themeluar një këshill të shkollës në shkollën e Juaj,? Përpunoni një plan të aktiviteteve „Zgjedhja e këshillit të shkollës“	Puna në grupe të vogla	Tabela e afishimit, dërrasa e zezë
1430	Pauzë			
1500	Vazhdim: Hartimi i një plani të aktiviteteve	Diskutimi i rezultateve të punës	Diskutim Pyetje-Përgjigje	
1545	Vazhdim me M3A3			

M3-A3 - Bashkëpunimi me prindër

Synimi

PM mund të bashkëpunojnë me prindër në mënyrë konstruktive

Qëllimi

PM përmirësojnë rezultatet mësimore të nxënësve duke përmirësuar mjedisin mësimor

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
1545	Hyrje	Synimi, qëllimi	Ligjërime	slajdi # 1 slajdi # 2
1550	Roli i prindërve në edukimin dhe arsimimin shkollor	<p>Prindërit janë një grup shumë heterogjen. Ata janë përfaqësues nga populli dhe kanë vetëm një gjë të përbashkët: që fëmiju i tyre shkon në shkollën Tuaj.</p> <p>Prindërit ndonjëherë janë shumë e ndonjëherë aspak të interesuar për shkollën. Pasi që prindërit mund të kenë ndikimin më të rëndësishëm në fëmijët e tyre për edukim pranë shkollës, ata duhet të përfshihen në punët e shkollës.</p> <p>Ndarja e votave në këshillin e shkollës merr parasysh këtë mendim.</p> <p>Puna e përbashkët e kujdestarëve të klasave dhe mësimitdhënësve me prindër duhet të përkrahët nga ana e drejtorisë së shkollës.</p> <p>Prindërit duhet të senzibilizohen për detyrat e tyre dhe nga ata duhet të kërkohet bashkëpunimi i tyre në aktivitetet përkatëse.</p> <p>Detyrat e prindërve:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● t'i sqarojnë fëmijut të tyre domethënien e shkollës ● të sigurojnë vijimin e rregullt të mësimeve ● të lexojnë dhe të diskutojnë- t'i përkushtohen fëmijut ● t'i inkurajojnë fëmijët për t'i shprehur mendimet e tyre dhe për t'i respektuar mendimet e tjera ● t'i kontrollojnë detyrat e shtëpisë ● t'i vënë në dispozicion nxënësit një vend të qetë për detyrat e shtëpisë dhe për të mësuar ● të bisedojnë me kujdestarin e klasës në lidhje me zhvillimin e fëmijut të tyre ● të përkrahin shkollën e „tyre“ në punën edukative me kërkesa të larta 	Ligjërime, diskutim	slajdi # 3

		Siç mund të shihet nga sllajdi 3, janë shumë detyra, të cilat duhet të përmbushen së bashku nga ana e prindërve dhe mësimitdhënësve.		
1610	Futja e prindërve në punën edukative	Prindërit duhet të njoftohen me obligimet dhe mundësitë e tyre. Për këtë përshtaten masat vijuese: <ol style="list-style-type: none"> Aktivitetet të ndryshme: <ul style="list-style-type: none"> Dita e dyerve të hapura Aktiviteti me rastin e fillimit të vitit shkollor Takimet me prindër, të organizuara nga kujdestarët e klasave Aktivitetet e tjera të shkollës (teatër, muzikë, festë verore, etj.), në të cilat ftohen prindërit Biseda individuale të mësimitdhënësve, kujdestarit të klasës dhe / ose drejtorit me prindër Transmetimet e raporteve të rregullta për prindër nga ana e kujdestarit të klasës mbi zhvillimin e fëmijut të tyre Prindërve t'iu sqarohet, se ata janë të mirëseardhur në shkollë në çdo kohë Të përpunohen së bashku me prindër problemet disiplinore të fëmijëve të tyre Trajnimi i mësimitdhënësve me temën „Obligimet e prindërve“ , të cilën drejtori e bën për të gjithë mësimitdhënësit 	Ligjërime	sllajdi # 4
1620	Zhvillimi i koncepteve për zbatim Referati dhe diskutimi	Ndani PM në grupe të vogla nga 2 persona. Detyra: Zhvilloni një koncept për njërin nga aktivitetet e lartpërmendura, se si kishit dëshiruar t'i bëni të qartë prindërve detyrat e tyre. Paramendoni veten, sikur të ishit drejtor. Referati i konceptit nga të gjitha grupet e vogla. Ilustrimet: sllajdi, tabela Flip, tabela për afishime Diskutimi vijues	Puna në grupe të vogla	sllajdi # 5 Tabela Flip, Tabela për afishime. Dërrasa e zezë
1800	Eventualisht aktiviteti i mbrëmjes			

M3-A4 - Bashkëpunimi me nxënës - Këshilli i nxënësve

Synimi

PM mund të bashkëpunojnë me nxënësit në mënyrë konstruktive

Qëllimi

PM përmirësojnë rezultatet mësimore të nxënësve duke përmirësuar mjedisin mësimor

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
0800	Hyrje	Synimi, qëllimi	Ligjërime	slajdi # 1 slajdi # 2
0810	Këshilli i nxënësve Statuti, Zgjedhja	Në të gjitha shkollat e mesme duhet të themelohet një këshill i nxënësve. Kriteret: <ol style="list-style-type: none"> 1. Zgjedhja: në mënyrë të fshehtë 2. Secila klasë dërgon së paku nga një përfaqësues Detyrat: <ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i mjedisit mësimor 2. Përmirësimi i kushteve të punës 3. Përkujdesja 4. Referimi i të gjitha interesave para drejtorit dhe këshillit të nxënësve Drejtori duhet të zhvillojë një skicë të statutit për këshillin e nxënësve duke i përfshirë rregullat për realizimin e zgjedhjeve dhe rregullat për rrjedhën e mbledhjeve.	Ligjërime, diskutim	slajdi # 3
0825	Përpunimi i një skice të statutit	Zhvilloni një rregullore për këshillin e nxënësve me kapitujt vijues: <ol style="list-style-type: none"> 1. Kushtet e përgjithshme juridike 2. Qëllimi i këshillit të nxënësve 3. Mënyra e punës 4. Përkrahja nga ana e drejtorisë së shkollës 5. Zgjedhja 6. Ndryshimet e rregullores 7. Rregullat përfundimtare Koha: 60' Ilustrimi: slajde	Puna në grupe të vogla	slajdi # 4
0925	Referat dhe diskutim mbi rezultatet e punës	Referati dhe diskutimi i propozimeve të grupeve. Përpilimi i një rregulloreje të tipit ideal, Pjesëmarrësve i shpërndahen rezultatet e punës	Diskutim i hapur	Projektori me dritën e ditës. Tabela për afishe Tabela Flip

M3-A4 - Bashkëpunimi me nxënës - Këshilli i nxënësve

Në ndërkohë	Pauzë			
	Referat dhe diskutim mbi rezultatet e punës			
deri 1100	Vazhdim me M3A5			

		<p>4. Përmbajtjet e mundshme të rregullave të shkollës</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Të gjithë pjesëtarët e shkollës duhet t'i përfillin ndjeshmëritë e të tjerëve. Përbuzjet, poshtërimet, kërcënimet dhe dhuna ndaj personave ose gjësendeve ndjekën penalisht. b. Mirëkuptimi i përgjithshëm dhe domosdoshmëria për rend dhe qetësi nëpër klasa dhe korridore janë parakushte për një atmosferë mësimore produktive. c. Nxënësit duhet të jenë nëpër klasat e tyre në kohë të përpiktë. Prindërit duhet ta informojnë shkollën në rast të vonimit të fëmiut të tyre ose në rastet kur ai nuk mund të ndjek mësimin. Kjo vlen për të gjitha arsyet e mundshme. d. Nxënësit vijjnë të përgatitur mirë në mësim, i kanë kryer të gjitha detyrat e shtëpisë ose detyrat tjera. e. Nxënësit nuk guxojnë të sjellin me vete armë ose gjësende të tjera të rrezikshme. Kjo vlen edhe për alkool dhe duhan. f. Nxënësit nuk guxojnë ta lëshojnë hapësirën e shkollës. Përgjashtim: nën mbikëqyrjen e një mësimitdhënësi ose me lejen e drejtorit apo të ndonjë mësimitdhënësi me përvojë të ngarkuar me detyrë . g. Në mësim nxënësit duhet të jenë të vëmendshëm. Diskutimet në klasë mbesin nën kontrollin e mësimitdhënësit. h. Nxënësit shprehen vetëm atëherë, kur mësimitdhënësi u jep fjalën. i. Ngrënia dhe pirja gjatë mësimit është e ndaluar. Kjo vlen edhe për çamçakëz dhe ëmbëlsira. 	<p>Shpërndarja e kopjeve tek PM, Autodidaktikë</p> <p>Ligjërim</p>	<p>Kopjet</p>
--	--	---	--	---------------

		<p>5. Njoftimi mbi rregullat shkollore</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtori kujdeset për atë, që të gjithë pjesëtarët e shkollës dhe prindërit të njoftohen mbi rregullat shkollore. Drejtori kujdeset për atë, që secili ndryshim i rregullave shkollore t'i lajmërohet të gjithëve. Drejtori kujdeset për atë, që rregullat shkollore t'i sqarohen me kujdes dhe maturi veçanërisht nxënësve të rinj Drejtori kujdeset për afishimin publik të rregullave shkollore Drejtori kujdeset për t'i dorëzuar me shkrim rregullat e shkollës secilit nxënës të ri. 		sllajdi # 6
1140 në ndërkohë pushimi i mesditës	Zhvillimi i rregullave të shkollës dhe i sanksioneve	Detyrë: Zhvilloni rregulla të dobishme praktike për shkollën Tuaj.	Punë në grupe të vogla	sllajdi # 7 sllajdi # 8 sllajdi # 9 sllajdi # 10 sllajdi # 11 Tabela Flip, Tabelë afishesh. Dërrasa e zezë
1430	Përpilimi i një katalogu model „Rregullat e sjelljes në shkollë“	Të gjitha rezultatet e punës së grupeve të vogla prezantohen dhe diskutohen. Të gjitha rregullat e sjelljes në shkollë, të cilat pranohen nga të gjithë, regjistrohen në katalogun model „Rregullat e sjelljes në shkollë“.	Ligjërime / Diskutim	Tabela Flip, Tabelë afishesh, Dërrasa e zezë
1500	Pauzë			
	Vazhdim me M3A6			

M3-A6 - Detyrë praktike

1. Verifikoni në shkollën tuaj rregullat e sjelljes të përpunuara këtu, se sa janë të dobishme në praktikë. Diskutoni në lidhje me këto me kolegët dhe drejtorin tuaj dhe pastaj raportoni këtu në lidhje me rezultatet.

(vlen për shkolla fillore dhe të mesme)

2. Përpunoni një plan veprues për shkollën tuaj, lidhur me rizgjedhjen e këshillit të shkollës? (vetëm për shkolla fillore)

Shënim shtesë:

Imagjinoni veten në postin e drejtorit të shkollës.

Ta marrim që këshilli i shkollës duhet të rizgjedhet deri më 01.02.2005.

Plani veprues duhet të përmbajë së paku:

- radhitjen kalendarike
- detyrat dhe
- kush duhet ti kryej këto detyra?

3. Këshilli i nxënësve.

Përpunoni për shkollën tuaj një statut për këshillin e nxënësve!

(vetëm për shkolla të mesme)

M3-A7 - Përfundim

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
1530		<ul style="list-style-type: none"> ● Përmbledhje ● Krahasimi i pritjeve me rrjedhën ● Vlerësimi i përmbajtjeve dhe metodave me pjesëmarrësit me qëllim të përmirësimit të konceptit ● Vështrim në ditën vijuese ● Përshëndetje 		slajdi M3A7
1600	Fund			

Vazhdim me ditën e tretë më.....

M3-A8 - Thellim

Qëllimi

Pjesëmarrësit kanë rastin, që së bashku me docentët dhe kolegët të thellojnë më tej materialin e trajtuar në dy ditët e para të modulit dhe të thelluar me anë të autodidaktikës sidhe në detyrën praktike.

Rrjedha

Koha	Tema	Përmbajtjet	Metodat	Ilustrimet
0900	Hyrje	Qëllimi	Ligjërime	slajdi # 1 slajdi # 2
0905		<ul style="list-style-type: none"> •Ligjërime dhe diskutime të moderuar të rasteve praktike, së bashku me shkëmbimin kolegjial të përvojave •Diskutime të thelluara të materialit mësimor 		
1600	Vazhdim me M3A9			
1700	Fund			

M3-A9 - Testim Moduli 3 Bashkëpunimi

Mbiemri:

Emri:

Data:


Udhëzim për zhvillimin e testit:

Pikat kanë së paku dy mundësi të zgjidhjes.

Prej tyre së paku njëra është e saktë.

Vini një kryq në mundësitë e sakta të zgjidhjes.

Në rast se keni vënë kryqin në një mundësi të gabuar, atëherë hiqni një vijë nëpër kuti:

 Teksti i përgjigjes...

Testin e kaloni nëse i përgjigjeni saktë 9 pikave prej gjithësej 11.

1: Drejtori është anëtar në këshillin e shkollës.

- Ai është kryetar.
- Ai nuk ka të drejtë vote.

2: Kryetarë të këshillit të shkollës mund të jenë

- vetëm prindërit, në rast se fëmiju i tyre shkon në shkollë.
- prindërit ose mësimdhënësit.
- prindërit. Mësimdhënësit dhe drejtori vetëm atëherë, në rast se janë më të vjetër se 35 vjeçar.

3: Në këshillin e shkollës drejtori ka të drejtë,

- të raporton mbi aktivitetet e shkollës.
- të raporton mbi financat e shkollës.
- të jep propozime të vendimeve dhe t'i përfaqëson ato nëpër debate.
- të përcakton rendin e ditës pa u marrë vesh me kryetarin.

4: Këshilli i shkollës

- duhet të fton nëpër mbledhje drejtorin komunal të arsimit dhe zyrtarin për arsim.
- mund të fton nëpër mbledhje drejtorin komunal për arsim dhe zyrtarin për arsim.

5: Detyrat e prindërve mes tjerash janë:

- të sigurohen për vijimin e rregullt të mësimi.
- të sqarojnë fëmijut të tyre domethënien e shkollës.
- përcaktimi i kohës së pauzës ndërmjet mësimëve.
- bisedimi me kujdestarin e klasës në lidhje me zhvillimin e fëmijut të tyre.

6: Përbërja e këshillit të shkollës

- zgjedhet një përfaqësues për tërë klasat paralele.
- secila klasë zgjedh një ose më shumë përfaqësues.

7: Statuti për këshillin e nxënësve

- duhet të skicohet nga ana e drejtorit.
- skicohet nga vet këshilli i nxënësve.

8: Zgjedhjet për këshillin e shkollës bëhen në mënyrë

- të hapur
- të fshehtë

9: Rregullat e sjelljes në shkollë

- zhvillohen nga ana e një grupi punues të përbërë prej mësimdhënësve.
- zhvillohen nga ana e drejtorit nën përfshirjen e mësimdhënësve dhe nxënësve.
- zhvillohen nga ana e një grupi punues të përbërë prej nxënësve.

10: Rregullat e reja të zhvilluara për sjelljen në shkollë

- duhet së pari të miratohen nga këshilli i shkollës dhe duhet të aprovohen përmes organit mbikëqyrës të shkollës.
- aprovohen nga Ministria e Arsimit.
- hyjnë në fuqi përmes drejtorit.

11: Mbi rregullat e sjelljes në shkollë

- duhet të njoftohet publikisht secili në shkollë. Për këtë janë të përshtatshme fletushkat me tekst, shpalljet nëpër aktivitetet e ndryshme etj.
- nuk duhet të njoftohet publikisht secili në shkollë.

Zgjidhjet

1	
	x

2	
	x

3	
	x
	x
	x

4	
	x

5	
	x
	x
	x

6	
	x

7	
	x

8	
	x

9	
	x

10	
	x

11	
	x